

Lajmet e fundit nga Rilindja Gjellbër & Platforma REKO

Projekti **ECSOK**, po sjell hapa konkret për transformimin e Kosovës drejt një ekonomie qarkore rigjeneruese. Ky projekt katërvjeçar (2024–2027), i zbatuar nga **Rilindja Gjellbër**, në partneritet me **Balkan Green Foundation, EC Ma Ndryshe** dhe **7Arte**, po realizohet me menaxhimin e **Community Development Fund – CDF** dhe me mbështetje financiare nga **Ambasada e Suedisë në Prishtinë**.

Publikimi i raportit të parë për industrinë e tekstit në Kosovë nga perspektiva e ekonomisë qarkore dhe tranzicionit të gjellbër


Më **24 qershor 2025**, në **Hotel Sirius**, Prishtinë, organizuam tryezën e diskutimit me rastin e publikimit të raportit të parë në vend që analizon industrinë e tekstit përmes lenteve të **ekonomisë qarkore** dhe tranzicionit të gjellbër

Raporti “Ekonomia qarkore dhe tranzicioni i gjellbër në industrinë e tekstit” sjell një pasqyrë të thelluar mbi gjendjen e sektorit të tekstit në Kosovë, duke identifikuar sfidat, boshllëqet dhe potencialet për zhvillim të qëndrueshëm. Gjetjet e tij u prezantuan para përfaqësuesve të institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile, duke hapur diskutime të rëndësishme mbi hapat që duhen ndërmarrë për të avancuar këtë industri drejt standardeve evropiane dhe globale të qëndrueshmërisë.

Për herë të parë në Kosovë, kemi sjell të dhëna të sakta nga sektori i industrisë së tekstit, pas intervistimit të mbi 100 biznese dhe 400 qytetarë, të dhëna që identifikojnë eksportin e importin dhe tendencën e tregut.

Ky është vetëm fillimi i një transformimi të domosdoshëm për industrinë tekstile në vend, drejt një ekonomie qarkore rigjeneruese dhe një të ardhmeje më të gjellbër.

[Lexo raportin këtu](#)



Regjistri i entiteteve qarkore në REKO

Një tjetër arritje e projektit është **krijimi i Regjistrimit të Entiteteve në Platformën REKO**. Ky regjistër do të shërbejë si një databazë kombëtare ku bizneset, organizatat, institucionet dhe qarkore

iniciativat që praktikojnë parime të ekonomisë mund të regjistrohen dhe të bëhen të aksesueshme për publikun. Kjo hapësirë digjitale ka për qëllim rritjen e transparencës, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve dhe fuqizimin e një ekosistemi më të qëndrueshëm ekonomik. Përmes këtij mekanizmi, **REKO** po bëhet ura që lidh bizneset, shoqërinë civile dhe institucionet me qytetarët, duke krijuar një mjedis të favorshëm për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë.

Edukim përmes videove & podcastit

Projekti **ECSOK** ka lansuar materiale të reja edukative për komunitetin, për të afruar konceptin e ekonomisë qarkore tek qytetarët dhe bizneset.



• **Çka është ekonomia qarkore?** – Një video e dedikuar për shpjegimin e thjeshtë dhe praktik të këtij modeli, duke ilustruar mënyrën se si riciklimi, ripërdorimi dhe inovacioni kontribuojnë në një ekonomi më të drejtë dhe më të pastër.

[Shiko videon këtu](#)

• **Podcasti “Sillu’ Pshillu” – Episodi 1**

Në episodin e parë, të titulluar “Sinergjia qarkore ndërmjet industrisë së ndërtimit dhe të tekstit”, mysafirë janë:

- **Urim Xharavina**, Drejtor Ekzekutiv i Rilindja e Gjellbër
- **Sytrime Dervisholli**, Drejtoreshë Ekzekutive e PREFAB Kosova Cluster

Ata ndajnë ide, sfida dhe vizione për ndërlidhjen e dy industrive kryesore në Kosovë, duke treguar se si bashkëpunimi qarkor mund të kthehet në bazë për zhvillim të gjellbër dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

[Dëgjo episodin këtu](#)

Politikat e reja të publikuara

Një pjesë thelbësore e projektit është avokimi për përmirësimin e kornizës ligjore në Kosovë. Deri më tani janë publikuar dy dokumente të rëndësishme politike:

- **Ndryshimi i Udhëzimit Administrativ** për të përfshirë kategoritë e reja të stimujve financiarë dhe granteve që mbështesin aktivitetet e ekonomisë qarkore. Ky hap synon të krijojë kushte më të mira për bizneset që investojnë në modele të qëndrueshme.
- **Themelimi i Fondit të Gjellbër për Kosovën** – një dokument politik që propozon një mekanizëm të ri financiar për të mbështetur tranzicionin e gjellbër në vend, duke ofruar stabilitet afatgjatë për projekte inovative dhe të qëndrueshme.

Këto politika janë shembull i qasjes së për të lidhur hulumtimin dhe avokimin me zgjidhje praktike për Kosovën. Këto aktivitete janë përcjellë me ngjarje diskutimi, në kuadër të projektit “Circular Economy for Green Transition”, të zbatuar Rilindja Gjellbër & People in Need Kosovo, me mbështetjen e Bashkimi Evropian në Kosovë.

Rast studimi me kompaninë ricikluese Izolimi Plast

Në kuadër të projektit është publikuar edhe një **rast studimi mbi kompaninë Izolimi Plast**. Ky biznes vendor tregon sesi mbetjet plastike mund të shndërrohen në produkte të vlefshme për sektorin e ndërtimit, duke ulur ndjeshëm sasinë e mbetjeve dhe duke ofruar një alternativë të qëndrueshme në treg. Përmes këtij shembulli, REKO dhe Rilindja Gjellbër nxisin bizneset e tjera të shohin mundësitë që sjell modeli i ekonomisë qarkore në krijimin e vlerës së re.

[Lexo rastin këtu](#)



Ekonomia qarkore globalisht

Në nivel botëror, ekonomia qarkore po shihet si një rrugë thelbësore për neutralitetin klimatik. Sipas raportit të fundit “Circularity Gap”, vetëm **7.2% e ekonomisë botërore është qarkore**, një rënie që dëshmon se sfidat janë ende të mëdha.

Megjithatë, në **Bashkimin Evropian**, përmes **Marrëveshjes së Gjellbër** dhe **Planit të Veprimit për Ekonominë Qarkore (CEAP)**, po krijohen standarde të reja që pritet të sjellin **700,000 vende të reja pune deri në vitin 2030-të** dhe të reduktojnë deri në **70% të emetimeve** të lidhura me përdorimin e materialeve. Për Kosovën, këto zhvillime janë një busull orientuese që e lidh vendin me trendet evropiane dhe globale të së ardhmes së gjellbër.

Përmes projektit **ECSOK, Rilindja Gjellbër** dhe partnerët po forcojnë themelet e ekonomisë qarkore në Kosovë, duke krijuar njohuri, politika, shembuj praktikë dhe mekanizma që e afrojnë vendin tonë më shumë me standardet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë.

